

Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së

Prizren, Kosovë
24. shkurt 2010.

Konsultimet u organizuan nga organizata joqeveritare *Fisnikët*. Në konsultime morën pjesë 41 pjesëmarrës/e dhe 11 vëzhgues, nga Prizreni, Malisheva, Vushtrria, Krusha, Rahoveci, Dragashi dhe Ferizaji. Për konsultimet raportuan stacionet televizive si *Deutsche Welle, Kosova, Prizren, Besa, Opinion*, gazeta *Koha Ditore* dhe *Kosova Sot* si dhe radiostacioni *ROA*. Në fjalën hyrëse të cilën e mbajti Nora Ahmetaj (Qendra për hulumtim, dokumentim dhe publikim, Prishtinë, Kosovë) foli për sesionin *Informimi i pjesëmarrësve për rrjedhën e procesit konsultativ në shtetet post-jugosllave dhe krahasimi me përvojat e shteteve tjera në vërtetimin e fakteve për të kaluarën*, ndërsa Besarta Vasija (Fondi për të Drejtën Humanitare, Prishtinë, Kosovë) ishte moderatorja e konsultimeve. Në përfundim të konsultimeve 23 pjesëmarrës/e nënshkruan deklaratën për anëtarësimin në Koalicionin për KOMRA-në.

Shqyrtimi i propozimeve, opinioneve dhe rekomandimet e pjesëmarrësve/eve:

Fjala konflikt duhet të zëvendësohet me termin luftë.

Shprehja konflikt duhet të fshihet si term dhe të zëvendësohet me termin luftë, sepse ne të gjithë e dimë, qytetarët tonë, njerëzit tonë, fqinjët tanë dhe bashkësia ndërkombëtare, të gjithë e dinë shumë mirë se ka pasur luftë në Kosovë dhe në hapësirat e shteteve të cilat kanë dalë nga Jugosllavia e shkatërruar. Mendoj se çdo herë duhet ta përdorim fjalën luftë. (Hamit Ademaj, Shoqata e familjeve të luftëtarëve të vrarë të UÇK-së, kryetarë, Prizren, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi Iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 24. shkurt 2010.)

KOMRA të përfshijë periudhën e viteve 1974.

(...) komisioni duhet ta gjejë mënyrën që të hulumtohen rastet e shumta të kohës më të hershme të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, ato para vitit 1990, sepse e kemi edhe vitin 1980, e kemi edhe vitin 1974. Ndaj shqiptarëve vazhdimisht ka pasur dhunë dhe keqtrajtim. (Ejup Kabashi, Shoqata e veteranëve të luftës, kryetar, Rahovec, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi Iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 24. shkurt 2010.)

Komisioni duhet t'i hulumtojë rastet e viteve 1987/89.

Lidhur me periudhën e cila do të duhej të përfshihet në punën e komisionit, lidhur me rrethanat në Kosovë, mendoj se viti i heqjes së autonomisë së Kosovës do të ishte koha më adekuate nga e cila do të duhej filluar hulumtimet e tilla. Pra, prej viti 1987, pastaj 1989. (Vildane Minci, Swiss Caritas, Prizren, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi Iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 24. shkurt 2010.)

Selia e KOMRA-së do të duhej të jetë jashtë territorit të ish Jugosllavisë.

Jam i mendimit se do të duhej të vendoset në një vend prej nga do të jetë e mundur të bëhet presion në parlamente, dhe ku presioni i politikës ndërkombëtare është më i fuqishmi. (Ejup Kabashi, Shoqata e veteranëve të luftës, kryetar, Rahovec, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi Iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 24. shkurt 2010.)

Selia e Komisionit të jetë në Slloveni.

Do të ishte mirë që selia e Komisionit të jetë në Slloveni. (Nazim Bahtiri, Youth Step, Vushtrri, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi Iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 24. shkurt 2010.)

Selia e Komisionit të jetë në Evropë.

(...) megjithatë selia e Komisionit të jetë diku në Evropë, ndoshta në Bruksel. (Qerim Bajrami, Selam, Prishtinë, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi Iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 24. shkurt 2010.)

Anëtarë i Komisionit të jetë dikush që është i përfshirë në Iniciativën për KOMRA-në.

Kush duhet të jetë komisionar? (...) Mendoj se do të ishte mirë që të jetë dikush që ka qenë i përfshirë në këto ngjarje, sepse ai person është treguesi apo përfaqësuesi më i denjë i tërë kësaj iniciative. (Haqif Ilazi, Shoqata e të burgosurve politik, Prizren, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi Iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 24. shkurt 2010.)

Në mandatin e KOMRA-së të jetë edhe hulumtimi i pjesëmarrjes së institucioneve shtetërore në krime.

Mendoj se diku nëpër materiale e kam parë një çështje shumë të rëndësishme, që njëri nga mandatet (kompetencat) e komisionit krahas gjithë atyre çështjeve tjera të qëlluara, të jetë edhe hulumtimi i pjesëmarrjes së institucioneve shtetërore në planifikimin dhe kryerjen e krimit. Kjo është vendimtare. (Qerim Bajrami, Selam, Prishtinë, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi Iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 24. shkurt 2010.)

Në kuadër të Komisionit duhet të ekzistojnë sektorë të ndryshëm.

Në kuadër të Komisionit duhet të jenë edhe sektorët e ndarë, së pari duhet të ekzistojë sektori për viktimat, tjetri për të burgosurit politik, sektori për të zhdukurit, sektori për të abuzuarit seksualisht gjatë kohës së luftës si dhe komisioni i veçantë për dëmet materiale. (Azem Pula, Shoqata e invalidëve të luftës, Prizren, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi Iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 24. shkurt 2010.)

KOMRA duhet ti mbledhë informatat nga autorët e krimeve.

(...) nuk e përjashtoj mundësinë që të arrihet deri te burimi i informatave dhe të realizohet biseda me autorët e krimeve. (Ejup Kabashi, Shoqata e veteranëve të luftës, kryetarë, Rahovec, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi Iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 24. shkurt 2010.)

Autorëve të krimit t'u jepet mundësia të japin deklaratë pasi të pendohen.

Sa i përket pjesëmarrjes së autorëve të krimeve të luftës, se a duhet të japin deklaratë apo jo, mendoj se duhet t'ua ofrojmë mundësinë për të dhënë deklaratë, por vetëm atëherë pasi të jenë penduar. (Bylbyl Duraku, Shoqata e të burgosurve politik, Prizren, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi Iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 24. shkurt 2010.)

Personi i cili është penduar nuk ka nevojë të japë deklaratë.

Nuk pajtohem me kolegun, personi i cili është penduar nuk ka nevojë të japë deklaratë, atij personi duhet t'i gjykohej. (Azem Pula, Shoqata e invalidëve të luftës, Prizren, Kosovë Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi Iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 24. shkurt 2010.)

Të shpërblehet secila informatë.

(...) secila informatë që merret nga qytetarët duhet të shpërblehet, sepse në të kundërtën të gjithë do të heshtin. (Azem Pula, Shoqata e invalidëve të luftës, Prizren, Kosovë Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi Iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 24. shkurt 2010.)